

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-32
A 58

Murat
ALIAJ

DIELLI DITËVE TOMA

tregime

691.985-32



SH-32
A58

MURAT ALIAJ

DIELLI
I DITËVE TONA

Tregime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LIBRI TARRA

LIBRI

LIBRI TARRA

Libri

Tirazhi 8000 kopje Formati 70 x 100/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re.
Tiranë, 1976

FLLAD REPARTESH

Njeriu i punës gjatë jetës së tij pëson ndryshime të mëdha, që as ai vetë nuk i kupton, sepse ato bëhen në punë e sipër, ca nga ca e gradualisht. Që t'i mbushet mendja njeriut për ndryshimet që ka bërë duhet të vinë momente të veçanta ku ai të verë në provë vetveten e të kuptojë ku ka arritur.

Kështu ndodhi edhe me ne atë vjeshtë të vitit 197. kur na sollën në repart për të bërë stazhin kimistët e rinj. Gjer atë kohë ne vetë kishim qenë si të thuash nën patronazhin e mjeshtrave më të vjetër me moshë e me vjetërsi pune, dhe ja me dhënjen në patronazh të kimistëve të rinj ne e ndjejmë veten si njerës që s'kishim më nevojë për tutelë, përkundrazi po na besohej ne përgatitja e më të rinjve. Kjo gjë na bëri e s'na bëri ta kuptonim se ne nuk ishim më ata të parët. Qe një rast tjetër ai që na e mbushi mendjen se ndryshimi ynë ishte edhe më i madh...

... Nuk kishim kaluar më shumë se dy muaj që punonim me kimistët e rinj kur pa pritur na ndodhi në repart një difekt, nga shkaku i të cilit ne e lamë mënjanë përkohësisht kujdesin për stazherët. Për

herë të parë, pas shumë vjetësh, reparti ynë u bë shkak që të ndërpritej prodhimi. Ky difekt tulate edhe mjeshtrat që kishin vite të gjata pune në këtë repart. Të gjithë filluam të vrisnim mendjen se ç'duhej bërë për eliminimin e difektit. Punonim pareshtur për të gjetur një zgjidhje të shpejtë.

Pranë kisha në çdo çast kolegët e mi: Bedon, mekanikun dhe Agronin, që kur fliste kërkonte me ngulm t'i dëgjohej fjala. Ky huq i kish ngelur që ahere kur vazhdonim shkollën e mesme. Me kalimin e viteve Agroni jo vetëm që nuk e zhduku dot këtë huq, por gjithnjë e më tepër vazhdonte t'i jepte rëndësi vetes. Krejt ndryshe qëndronte puna me Bedon. Ai ishte njeri kokulur, që edhe nga rasti më i thjeshtë kërkonte të nxirrte mësim. I dhënë me shpirt pas punës, ta kishte qejfi ta kishte pranë dhe të konsultoheshe me të.

Nëpër këmbët tona silleshin edhe stazherët me atë shqetësimin e tyre të sinqertë për difektin. Ne e shihnim interesimin e tyre të madh, por nuk mund t'u thoshnim dot asnjë fjalë, derisa edhe vetë nuk kishin arritur ndonjë përfundim.

Herë pas here dëgjonim gjëminin e ndonjë kolone që shkarkonte në ajër presionin. Rënkimi i saj na dukej sikur shpërthente na gjokset tanë.

Urdhri ishte i prerë: të montohej vinçi dhe të fillonte menjëherë zbërthimi i kolonës. Kjo punë, që na kushtonte disa muaj ndalesë, tashmë ishte e pashmangshme. Ne shihnim njeri-tjetrin në sy dhe nuk na bënin duart ta kapnim varenë. Na dhimbte që ta shihnim uzinën në heshtje për një kohë kaq të gjatë. Kishim kërkuar vetëm tri ditë afat, për të gjetur ndonjë formë që mund ta shkurtonte kohën e ndalesës së uzinës.

Dy ditët e para kaluan duke gërmuar nëpër ato të fshehta të kimisë, që nuk kishim mundur t'i mësonim nga përvoja e përditshme. Sa zbulime të mëdha i detyron rastësisë njerëzimi! Po a kishim ne kohë që të prisnim pjekjen e mollëve, si Njutoni? Gjithçka mund të na vinte në ndihmë, por rastësia, kurrrë!...

Pranë barrakës së repartit stazhierët prisnin urdhër për të filluar nga puna. Kishin grumbulluar çelësa të mëdhenj, nga ata lloje që përdroreshin në kolonë dhe duke kaluar kohën me shaka, nuk e shkëpusnin vështrimin nga lartësitë.

Ditën e tretë u ngjitëm rishtas shkallëve të metalta të kolonës. Pas nesh erdhën edhe dy nga stazherët. Me blloqet e shënimeve në dorë, ata prisnin të merrnin udhëzime.

— Ky do të jetë ndonjë difekt i atij lloji ku nuk duhet futur dora pa u siguruar mirë, — tha Agroni. — Ka shumë të papritura.

— Jo. Këtu dora duhet futur patjetër, çfarëdo e papritur që të jetë! — tha Bedoja, që ndonëse fjalëpakë, po sa për guximin i hiqje festen. Ishte tjetër punë kur s'dinte ç'duhej bërë. Ai priste të na ndihmonte për zbatimin e ndonjë ideje, dhe megjithëse ne hëpërhë nuk kishim asnjë ide, ai përsëri na rrinte pranë dhe mundohej të na ndihmonte.

— Duart vërtet duhen futur, — thashë edhe unë, — por duhet menduar mirë ku do të futen.

— Deri tani askujt nuk i ka ndodhur ndonjëherë që ta gjejë difektin qesim — tha Agroni.

— Mos u ngutni, — tha Bedoja me atë tonin e tij të qetë duke nxjerrë nga dosja një sërë librash që flisnin për ndërtimin e këtyre lloj kolonave.

Gjatë një farë kohe ai na freskoi kujtesën me

mjaft gjëra që na duheshin. Rrinim ulur këmbëkryq në majë të kolonës dhe kalonim para syve skemat e ndryshme. Erërat e lartësive na përkëdhelnin flokët dhe na zgjeronin kraharorin.

Që ta zbrazje lëndën e «konsumuar» të kolonës dhe ta mbushje prapë me të re, duheshin të paktën edhe tre muaj të tjerë. Po kalonte edhe dita e tretë e ndalesës, ndërsa ne akoma nuk po vendosnim ç'duhej bërë. Shumica ishin të mendimit të përvishnim llërët dhe t'i hynim punës së gjatë për tre muaj të tërë. Por ne vrisnim mendjen për t'i dhënë një zgjidhje shumë më të mirë.

Faqja tre e manualit: *Njohuri të përgjithshme.*

Pjesë të njohura e të lexuara, pjesë mbi të cilat kishim djersitur qindra herë. Mos vallë pikërisht në ato faqe na ishte fshehur ajo që na duhej kaq shumë? Lexonim pjesë të shkëputura nga kapituj të ndryshëm. Bedoja rrinte sa rrinte dhe nxirrte nga dosja e tij manuale të tjera. I pamë të gjithë me radhë. Vetëm Agronit i shkonte ndonjëherë mendja ters: i dukej sikur frika nga puna e madhe që do të na hapej na bënte që të kërkonim kaq gjatë.

— Së fundi edhe juve do t'ju mbushet mendja se punës së madhe për tre muaj me radhë s'do t'i shpëtojmë dot.

— Edhe mundet, more Agron! — tha Bedoja.

Ç'tip i çuditshëm ky Agroni! Bedoja kishte arritur tek *vetitë e lëndës së mbushur në kolonë*. I lexuam disa herë me zë. Lënda e «*helmuar*» nga përdorimi, duhej ndërruar patjetër. Këtë mësim të manualit e kishim përvetësuar qysh me njohjen e kolonave, por puna ishte se ndërrimi kushtonte shumë, tre muaj ndalesë. Kjo rrezikonte planin e prodhimit.

— Vajtën kaq vjet që merremi me këto kolona

dhe na duket e hidhur të pranojmë se s'paskemi mësuar gjë prej gjëje. Ajo që ka më shumë rëndësi nga çka mësova këtu, është se i njëjti difekt nuk u përsëritka dy herë.

— Kjo s'është e thënë, Bedo.

Agroni, me sa duket, u bë gati të përsëriste prapë mendimin e tij, por heshti.

— Unë e kam një ide, por kjo duhet provuar, — tha Bedoja.

— Po na e thuaj!

— Sikur t'i fusim kolonës avuj uji nga lart? Ata mund ta pastrojnë lëndën dhe mund të rrëmbejnë me vete një pjesë të «helmit». Kjo është fare e thjeshtë. Manuali hesht për këtë. Ai me sa duket e përjashton fare mundësinë e përsëritjes së lëndës, por ja që fare thjeshtë mund t'ia zgjasim jetën asaj më shumë se dy vjet. . .

— Do pasur parasysh se avujt mund të dëmtojnë vetitë e tjera të dobishme, — thashë unë.

— Këtë mund ta provojmë lehtë në laborator.

— Laborant po bëhem unë! — tha Agroni me entuziazëm.

Gjithë atë natë qëndruam kokë më kokë, pranë njëri-tjetrit. Kurrë ndonjëherë shqetësimi i përbashkët nuk kishte qenë më i madh. Orët e përgjumura të natës, nën flakën e lehtë që nxirrte llampa e alkoolit, kalonin pa u vënë re. Avujt e nxehtë na lehtëtonin fytyrën. Lënda e pastruar me avuj uji po jepte shenja të mira: ajo mund të përdorej përsëri. Ky rezultat ishte aq i papritur sa ne e përsëritëm edhe njëherë në kushte shumë më të vështira. Por rezultati përsëri doli njësoj.

Agroni nuk u besonte syve tek i shihte avujt e

kuqërremtë që gjenin rrugë kalimi pranë faqeve të epruvetës dhe delnin jasht të lirë. Gjumi përmbi qepallat tona na kishte lënë vetëm një mpirje të vogël, të pakuptueshme. Ajo natë që aq e shkurtër, sa nuk na mjaftoi as për të përqafuar njeritjetrin.

Në mëngjes shkuam te kolona. Agroni s'iu nda për gjithë natën ventilin që fuste avull në të. Ajo gurgullonte lehtë përbrenda. Në faqet e jashtme prej çeliku ende nuk kishte nisur të ndihej ngrohja e avullit që vazhdonim t'i fusnim përbrenda. Agroni rrinte sa rrinte dhe i shtonte nga një rrotullim ventilin.

Ishim akoma duke përgjuar zhurmën e mekur të kolonës, kur agimi e bëri copë napën e zezë që mbante fshehur horizontet. Shokët erdhën me forca të reja për të na ndërruar. Ata e shihnin me sytë e tyre ç'po bëhej me kolonën.

Kaq të lumtur e ndiem veten kur i pamë shokët që iu përveshën me forca të reja punës, sa ishim gati ta vazhdonim vetë atje ku e kishim lënë. «Ja, kështu bëhet puna pjesa më e bukur e jetës»! thashë me vete dhe këmbët s'më bënë të largohesha nga reparti.

*

*

*

Si një kështjellë e hekurt ngrihej në faqe të kodrës uzina. Avujt e saj të bardhë ngriheshin lart në horizontin e kthjellët të pranverës.

Nëpër shkallët e repartit dëgjuam hapa. Dy njerëz vinin drejt nesh. Ishte sekretari i Partisë dhe she-